

**AKT THEMELIMI**  
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“SARANDA NET” SHPK**

Sot, më datë 28/12/2023 personat e poshtëshënuar:

- **Taulant Qëndro**, lindur më 20/05/1973 në Gjirokastrë dhe banues në Tiranë, identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit ID me nr. personal H30520185V, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.
- **Dritjona Caushi**, lindur më 31/12/1987 në Krahës dhe banuese në Tepelenë, identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit ID me nr. personal 176231017V, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.
- **Visi Caushi**, lindur më 13/07/1988 në Kalivaç dhe banues në Tepelenë, identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit ID me nr. personal 180713036K, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.
- **Eno Veshi**, lindur më 17/05/1982 në Tiranë dhe banues në Tiranë, identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit ID me nr. personal I20517072O, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

**VENDOSËN:**

**NENI 1**

Me vullnet të plotë dhe në përputhje me legjislacionin shqiptar krijimin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar me emrin “SARANDA NET” SH.P.K.

**NENI 2**

Shoqëria do të ketë selinë në adresën: SARANDE, Kryqëzimi i rrugës "Onhezmi" më rrugën "Adem Sheme" (përbri Fast Food "Çuçi").  
Shoqëria mund të hapë dhe mbyll zyra dhe/ose të kryejë aktivitete në vende të tjera, brenda dhe/ose jashtë Republikës së Shqipërisë, përveç selisë së Shoqërisë.

**NENI 3**

Objekti i shoqërisë do të konsistojë në:

Shoqëria do të ketë për objekt të veprimtarisë së saj kryerjen e çdo veprimtarie të lejuar nga ligji dhe/ose pjesëmarrjen në çdo veprimtari apo aktivitet të ligjshëm që mund të kryejë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e krijuar në bazë të legjislacionit shqiptar dhe në veçanti: shërbime në fushën e komunikimeve elektronike si: Operator i rrjetit dhe shërbimeve për transmetim të dhënash/internet, IP TV, VoIP. Shërbime të linjave me qera. Aktiviteti i tregtimit me shumicë dhe pakicë dhe import-eksport të makinerive, paisjeve e veglave të fushës së telekomunikacionit. Import eksport për mallra të ndryshme për nevoja të ushtrimit të aktivitetit të shoqërisë.



#### NENI 4

Kapitali themeltar i Shoqërisë është 4'000'000 (katër milionë) Lekë dhe përbëhet nga 4 (katër) kuota me vlere 1'000'000 (një milion) Lekë që përbën 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë. Kjo vlerë do të derdhet në llogarinë bankare të hapur në emrin e shoqërisë brenda 30 ditëve nga krijimi i saj.

Kontributi i ortakëve do të jetë në para ose në natyrë.

#### NENI 5

Organet drejtuese dhe vendimarrëse të shoqërisë janë:

1. Asambleja e përgjithshme e ortakëve.
2. Administratori.

Asambleja e përgjithshme e ortakëve është organi vendimmarrës i shoqërisë dhe vepron në përputhje me statutin dhe ligjet në fuqi.

Administratori ka të gjitha kompetencat për administrimin e shoqërisë me përjashtim të atyre që nevojitet miratimi nga Asambleja e përgjithshme e ortakëve.

#### NENI 6

1. Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë, për një mandat 5 (pesë) vjeçar, me të drejtë riemërimi. Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

2. Administrator i kësaj shoqërie me mandat 5 (pesë) vjeçar, me të drejtë riemërimi do të jetë Eno Veshi, lindur më 17/05/1982 në Tiranë, banues në Tiranë, identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit ID me nr. personal I205170720, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

#### NENI 7

Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj për një afat të pacaktuar që nga momenti i regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

#### NENI 8

Ky akt themelimi është hartuar në gjuhën shqipe në 4 kopje me të njëjtën fuqi ligjore.

Për sa nuk parashikohet në këtë akt themelimi, gjejnë zbatim dispozitat e Ligjit Nr. 9901, Dt. 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, Ligjit Nr. 9723, Dt. 03.05.2007 "Për regjistrimin e biznesit", si dhe legjisllacioni në fuqi.

Nënshkruar më datë 28/12/2023.

#### ORTAKËT THEMELUES

Taulant Qëndro

Dritjona Caushi

Visi Caushi

Eno Veshi

*Taulant Qëndro*

*Dritjona Caushi*

*Visi Caushi*

*Eno Veshi*

